



**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**  
**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

---

**K.Dh.Shk.II.nr.876/2022**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS NË PRISHTINË**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Franciska Zhitija -Ymeri kryetare e kolegjit, Faton Barjami dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit N.N.P “F...” nga Suhareka, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Xhevdet Krasniqi dhe Ilir Nikqi avokat nga Prishtina, kundër të paditurës C.S.A.-sh.p.k, me numër unik identifikues .... me seli në Prishtinë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Gafurr Elshani avokat nga Prishtina, për shkak të mos përmbushjes së kontratës, në shumë të përgjithshme prej 23,091.00€, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.418/2019, të datës; 07.12.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën 17.11.2022, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e paditësit N.N.P“F...” nga Suhareka, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, EK.nr.418/2019, të datës 07.12.2021, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e ankimuar EK.nr.418/2019, të datës 07.12.2021, ka vendosur si në vijim;

“I.REFUZOHET e pa bazuar kërkesëpadia e paditëses N.N.P “F...”, me numër unik identifikues .... me seli në Komunën e Suharekës, me të cilën ka kërkuar që të DETYROHET e paditura “C.S.A.” Sh.p.k, me numër unik identifikues ...., me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të mos përmbushjes së kontratës të datës 06.08.2012, t’ia paguaj shumën prej 20,091.00euro (njëzetmijë e nëntëdhjetë e një ), me kamatë vjetore, në lartësi prej 8%, duke filluar nga data 19.11.2012, dita

kur është lidhur kontrata lëndore, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes-pranimit të këtij aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit.

II.DETYROHET paditësja N.N.P “F...”, me numër unik identifikues .... me seli në Komunën e Suharekës, që në emër të shpenzimeve të kësaj procedure, t’ia paguaj të paditurës “C.S.A.” Sh.p.k, me numër unik identifikues ....., me seli në Prishtinë, shumë prej 2,513.60 euro (dymijë e pesëqind e trembëdhjetë euro e gjashtëdhjetë cent), në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes-pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit.”

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë paditësi, për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkëljes së dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që ankesa të aprovohet në tërësi si e bazuar duke e prishur aktgjykimin e ankimuar dhe ta kthej çështjen në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqit e paditura ku ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i ankimuar.

Gjykata Komerciale si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, N.N.P “F...”, me numër unik identifikues .... me seli në Komunën e Suharekës, ka paraqitur padi kundër të paditurës “C.S.A.” Sh.p.k, me numër unik identifikues ....., me seli në Prishtinë, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet që paditësit t’ia paguaj shumë prej 23.091.00euro, me kamatë në lartësi prej 8% në vit, duke filluar nga data e lidhjes së kontratës gjer në pagesën definitive, si dhe ka kërkuar shpenzimet e procedurës në shumë prej 2,513.60€.

Gjykata e shkallës së parë pas administrimit të provave ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është pabazuar, me arsyetim se lidhur me legjitimitetin e të paditurës në këtë procedurë ka ardh në përfundim se e paditura ka legjitimitet pasivë në këtë procedurë për faktin se e paditura në përgjigje në padi të datës 19.11.2014, nuk e mohon çështjen e legjitimitetit, por thekson se padia dhe kërkespadija e paditësit është e pa bazuar në prova, ngase faturën e datës 19.11.2012, e prezentuar si provë nga paditësja e që ka rezultuar nga kontrata lëndore e datës 06.08.2012, nuk ju ka dorëzuar asnjëherë të paditurës në Prishtinë. Madje përfaqësuesi i të paditurës as në seancën e datë 07.05.2015 nuk e ka mohuar çështjen e legjitimitetit të paditurës në këtë procedurë, por ka deklaruar se paditësja nuk e ka përmbush kontratën sepse nuk është dorëzuar asnjëherë projekti tek e paditura. Ka shtuar se as pronari i të paditurës M.M. që ka deklaruar në seancën e datës 20.05.2015 nuk e ka mohuar çështjen e legjitimitetit të paditurës në këtë seancë. Për më tepër kontrata e datës 06.08.2012 është e nënshkruar nga bashkëpuntorët e të paditurës, siq e deklaroi njëri nga pronarët e të paditurës në seancën e datës 20.05.2015, poashtu vula që është e vendosur

në kontratën lëndore, e mban përshkrimin “Prishtinë-Kosovë”, dhe njëri nga pronarët është M.M., i cili është dëgjuar si dëshmitar në këtë rast nuk e ka mohuar çështjen e legjitimitetit, andaj për këtë arsye e paditura e ka legjitimitetin pasiv. Ndër të tjera gjykata e shkallës së parë ka theksuar se pasvlerësimi të provave ka ardhë në përfundim se në mesë paditësit dhe të paditurës ka lind detyrimet nga neni 3 i kontratës së datës 06.08.2012 e lidhurë në mesë të ndërgjyqësve 2 ditë nga data e dorëzimit të projektit që ishte objekt i kontratës së lartëcekur, mirëpo paditësi nuk ka prezentuar gjykatës asnjë provë shkresore se projekti lëndor dhe fatura e datës së lartë cekur, që ja ka dorëzuar të paditurës, kështu gjykata e shkallës së parë ka shtuar se paditësi për asnjë nga kërkesat e saj në këtë rast, nuk ka prezentuar prova që do ti argumentonin pretendimet e saj, andaj dhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore kujdeset dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar të drejtën materiale përkatësisht dispozitivën e nenit 7 par.1 të LPK-së ku përcaktohet se *“Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë provat me të cilat konstatohen faktet e tilla”*. Në rastin konkret rezulton se paditësja me asnjë provë nuk e ka argumentuar faktin se të paditurës ju është dorëzuar projekti që ishte objekti i kontratës e as nuk e ka provuar faktin me ndonjë provë materiale se të paditurës iu është dorëzuar fatura e datës 19.11.2012, po ashtu paditësi nuk ka ofruar asnjë propozim për xjerrjen e ndonjë prove të re mbi të cilën do të mund të konstatohet pretendimet e saj ashtu sipas nenit 319 pargraf 1 të LPK-së, ku është paraparë se *“ Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provojë faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta”*.

Kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejtë ka zbatuar edhe dispozitivën e nenit 322 pargraf 1 dhe 2 LPK-së, kur e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesëpadinë, pasi që paditësit nuk ka mundur që më asnjë provë konkrete ta vërtetojë faktin se e ka dorëzuar projektin të paditurës si dhe faturën në fjalë.

Gjykata i vlerësoi edhe pretendimet tjera të palës paditëse lidhur me gjendjen faktike, por gjeti se të njëjtat janë të pabazuara sepse gjykata e shkallës së parë në mënyrë të plotë, e ka vërtetuar gjendjen faktike, ndërsa pretendimet e paditësit janë në kundërshtim me provat që gjenden në shkresat e lëndës. Po ashtu kjo gjykatë vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore lidhur me atë se paditësit i është paguar 3,000.00euro nga ana e të paditurës në emër të kontratës, por për gjykatën ishte e pa kjashtë, ngase askund në shkresa të lëndës paditësi nuk e ka argumentuar me provë se më të vërtet kjo shumë e cekur i është paguar në emër të kontratës datës 06.08.2012 ku si objekt i kësaj kontrate ishte projekti detal i llogarisë statike për hotelin A....në Kashare - Tiran, apo është

paguar për donjë shërbim tjetër, mënyrën e pagesë së saj, kur është bër ajo pagesë, andaj për të gjitha këto paditësi nuk ka qenë në gjendje ti vërtetoj as gjatë procedurës e as në fazën e ankimimit.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë.

Nga të cekurat u vendos si në dispozitiv në bazë të nenit 195.1 nën pikën d), e lidhur me nenin 200 të LPK-së.

**GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË**

**Dhomat e shkallës së dytë,**

**K.Dh.Shk.II.nr.876/2022, dt.17.11.2022**

**KRYETARE E KOLEGJIT,  
Franciska Zhitija-Ymeri**